

## KARAKTERISTIKA TË PËRGGJITHSHME FIZIKO – GJEOGRAFIKE NË MALËSINË E ÇERMENIKËS

Elvira BOLLOBANI <sup>1</sup>

### ABSTRAKT

Malësia e Çermenikës shtrihet në pjesën qendrore të krahinës malore qendrore të Republikës së Shqipërisë. Në këtë artikull trajtohen veçoritë morfologjike dhe morfogjenetike të malësisë së Çermenikës, pozita gjeografike, ndërtimi gjeologjik dhe disa veçori fiziko – gjeografike të kësaj malësie.

Ky punim ka si qëllim evidentimin e veçorive morfologjike e morfogjenetike të njësive përbërëse të malësisë së Çermenikës. Për realizimin e këtij studimi është shfrytëzuar literatura e shkruar e të njëjtës fushë si dhe konsultime me specialistë të fushës së studimit. Ky punim do të shërbejë për studiesit, studentët dhe për amatorët e gjeografisë, të cilët kanë dëshirë të informohen për këtë zonë.

**Fjalë kyçe:** malësi, Çermenikë, lug, kurriz malor.

### ABSTRACT

The highland of Çermenika is laid on the central part of the central part of Albanian Republic mountain. In that article has been treated the morphological and morphogenetical features of the Çermenika highlands, geographical position, the geological construction and some of the physic – geographical features of that highland.

This material has as an purpose the evidentation of morphological and morphogenetic features of including parts of Çermenika highland. For realization of this studing is is explored the written literature of the same field as well as consultation with the specialists of the studing field. This working is going to serve to the other studies, to the students as well as to the amatores of geography, which would like to be informed for that zone of study.

**Key words:** highlands, Çermenike, mountain ridge, trough.

---

<sup>1</sup> **Msc. Elvira BOLLOBANI (DODOVECI)**, elvirabollobani@hotmail.com  
Fakulteti i Biznesit, Universiteti “A. Moisiu” Durrës, Part – time,  
Tel. + 355 0693892995  
Adresa: Rruga “Lura”, Lagja 17, Durrës, Shqipëri

## HYRJE

Në kuadrin natyror malësia e Çermenikës shtrihet në pjesën jugore të kësaj zone midis lugut tektonik të Llangës në lindje, atij të Shmilit nga perëndimi, gryka e Shkumbinit në jug, kurse në VP arrin deri tek fusha e Bizës dhe lugina e sipërme e lumit Mati. Shtrirja e kësaj malësie i kalon kufijtë e Çermenikës si emërtim etnografik, prandaj nuk ka përse të krijohen keqkuptime në lidhje me ruajtjen e këtij emërtimi (E. Derbyshire, 1976). Kufijtë e lartpërmendur të kësaj malësie përfshihen në pjesën dërmuese tek zona tektonike Mirdita gjatë sektorit ku mbizotërojnë shkëmbinj të terrigjenë dhe ato gëlqerorë, kurse ultrabazikët ndërtojnë masivin e Kutërmanit nga JP i saj (M. Shallo, Th. Gjata & A. Vranai, 1980). Në përgjithësi këta shkëmbinj kanë kontakte tektonike midis tyre, krahas shkëputjeve të shumta në masën e secilit prej tyre, duke ndikuar drejtpërdrejtë në mbizotërimin e strukturës shkëputëse. Ripërtëritjet nga tektonika ngritëse e vazhdueshme deri në ditët e sotme kanë përcaktuar, gjithashtu, karakterin aktiv morfologjenik të këtyre shkëputjeve, të cilat drejtojnë evolucionin morfologjik të relievit të kësaj malësie.

Në sektorin perëndimor të kësaj malësie me rëndësi morfologjike të shprehur, paraqitet shkëputja tektonike mbihipëse midis zonës tektonike Mirdita mbi atë të Krastës. Brezi i shkatërrimit gjatë ballit të kësaj mbihipjeje shtrihet midis Ballgjinit në veri dhe Qafës nga jugu, në të cilin flihoodet e  $J_3Cr_1$  mbihipin mbi fliшин  $Cr_2Pg_{1-2}$ , duke u shprehur në reliev kryesisht me lugjet e degëve të përroit të Rrapunit, veçanërisht ai i Gurakuqit dhe i Shmilit (Grup autorësh, 1983). Në sektorin perëndimor të Çermenikës, veçanërisht nga qafa e Rinasit në veri deri tek Labinoti Mal nga jugu, shtrihen strukturat antiklinale dytësore të gëlqerorëve kretak të zonës së Krastës, të cilën shprehen drejtpërdrejtë në reliev me kurrize malore mbi 1200 – 1400 m lartësi. Shtrirja në trajtë gjysmëharkore e këtyre strukturave me lugëzim nga lindja midis Gurakuqit dhe Qafës, ka përcaktuar një trajtë të tillë të kurrizit malor gjatë tyre, duke përbërë njëkohësisht kurrizin ujëndarës të pellgut ujëmbledhës të Rrapunit nga perëndimi e JP me atë të lumit Erzen në VP. Me tipare morfologjike karakteristike paraqitet gjithashtu, sektori lindor i kësaj malësie midis lugut të Gurakuqit dhe atij të Lunikut, i cili dallohet për një drejtim copëtimi afro meridional. Kjo dukuri morfologjike lidhet drejtpërdrejtë me shtrirjen e lartësive më të mëdha të kësaj malësie pothuajse në qendër të saj, midis Gurit të Muzhaqit dhe Kaptinës, kurse drejt jugut lartësitë ulen doradorës drejt lugut të rrjedhjes së poshtme të Rrapunit deri në afërsi të Librazhdit. Një shtrirje e tillë e formave të relievit të Çermenikës në sektorin lindor të saj, lidhen drejtpërdrejtë me pykëzimin e

sinklinalit molasik tortonian të Librazhdit drejt VP ku kalon lumi i Shkumbinit, i cili përbën njëherazi nivelin bazë të erozionit të përroit të Rrapunit.

Theksojmë se dukurinë morfologjike të jashtme kryesore e përbën rrjeti i dendur i degëzimeve të këtij përroi, veçanërisht ai i Lunikut dhe Zallit të Gjurajt, të cilët kanë arritur me erozion regresiv deri në lartësitë kulmore të lartpërmendura të kësaj malësie (Gj. Gruda, 1994). Në tiparet morfologjike të kësaj malësie spikat drejtimi VL – JP i shtrirjes së lugishteve dhe kurrizeve malore ndarëse në degët e majta të përroit të Rrapunit, pra gjatë sektorit lindor, kurse në sektorin perëndimor, pra nga e djathta e rrjedhjes së këtij përroi, përkundrazi, ato kanë një shtrirje VP – JL. Këtu bën përjashtim lugu i përroit të Kostenjës, i cili shtrihet pothuajse në qendër të kësaj malësie me drejtim afro meridional, duke përcaktuar një shtrirje të tillë të kurrizeve malore kufizuese, veçanërisht të atij nga e djathta e tij. Në varësi të faktorëve morfostrukturorë dhe kushteve tektodinamike të lartpërmendura në këtë malësi veçohen këto nënnyjësi morfologjike: mali i Lunikut, i Mirakës, Gurit të Muzhaqit, i Ulokut (Kutërmanit), i Ostrovicës së bashku me lugun e Lunikut, Zallit të Gjurajt dhe të Qarrishtës, të cilët do të trajtohen në vazhdim.

## **KURRIZI MALOR I LUNIKUT**

Në kuadrin e përgjithshëm të malësisë së Çermenikës kurrizi malor i Lunikut shtrihet në sektorin lindor të saj midis lugut tektonik me të njëjtin emër në VP, atij të Llangës e Qarrishtës nga JL, shkallës strukturore të Zgoshtit në JP dhe qafës tektonike të Studës nga VL. Drejtimi i përgjithshëm i shtrirjes është VL – JP rreth 10 km gjatësi, një gjerësi 3 – 4 km dhe lartësi 1200 – 1800 m (Maja e Gurit 1825 m), duke u përputhur gati plotësisht me përmasat e antiklinalit karbonatik me të njëjtin emër dhe amplitudën e ngritjes tektonike të re të kësaj strukture, gjatë të cilës ai është modeluar. Në kushtet e përbërjes gëlqerore të këtij vargmali këto shkëputje kanë nxitur njëkohësisht zhvillimin e dukurive karstogjenike në evolucionin e relievit, falë shkallës së dendur të erozionit të këtyre shkëmbinjve. Format karstike përfaqësohen nga fusha e Përvallës, e cila është modeluar mbi një shkallë strukturore në lartësi 1522 m gjatë një shkëputje tektonike në krahun VP të antiklinalit të Lunikut (Grup autorësh, 1991). Zhvillimin më të dendur relievi karstik gjatë këtij kurrizi e ka midis majës së Lunikut dhe majës së Gurit (1825 m), i cili përfaqësohet nga hinka dhe pjesërisht dolina, megjithatë, densiteti më i madh i zhvillimit të karstit takohet tek blloku VP midis dy grykave të lartpërmendura, duke u lidhur drejtpërdrejtë me shtrirjen më të gjerë të shkëmbinjve gëlqerorë.

## **GURI I MUZHAQIT**

Kurrizi kodrinoro – malor i Kutermanit në drejtim të veriut ndërpritet prej atij të Gurit të Muzhaqit nga lugu i linjës së shkëputjes i rrjedhjes së sipërme të përroit të Rrapunit (Zalli i Shmilit).

Një dukuri morfologjike karakteristike e këtij kurrizi malor kodrinoro – malor është fakti se lartësia më e madhe e tij nuk përputhet me përmasat e shtrirjes së shkëmbinjve gëlqerorë, pra Guri i Muzhaqit shtrihet në skajin verior ku këta shkëmbinj kanë njëkohësisht shtrirje gati sa gjysma e pjesës jugore. Ky tipar morfologjik është dëshmi e shprehur e rolit vendimtar në relief të tektonikës bllokore të re, e cila ka përcaktuar jo vetëm lartësinë më të madhe, por njëkohësisht një evolucion të shpejtë të relievit në pjesën veriore të këtij kurrizi malor (Sh. Aliaj, 2012). Kurrizi kodrinoro – malor i Gurit të Muzhaqit ndërpritet përfundimisht mbi shkallën strukturore molasike midis Zdrajshit dhe Floqit me lartësi 400 – 700 m, duke krijuar një kontrast morfologjik të shprehur me relievin e nivelit të parë të shkallës strukturore gëlqerore ndërmjet këtyre dy fshatrave

## **KURRIZI MALOR I MIRAKËS**

Ky kurrizë malor shtrihet në skajin jugor të malësisë së Gollobordës, me kufij natyror të shprehur pothuajse në tërë përmasat e shtrirjes së tij, të cilët përfaqësohen prej kurrizit malor të Lunikut në VP, fusha e Studës dhe ajo e Stëblevës nga veriu, duke përfshirë njëherazi lugun e linjës së shkëputjes të Llangës, kurse nga jugu përfundon në lugun me të njëjtën origjinë, atë të Qarrishtës. Natyrisht, përmasat më të mëdha dhe tiparet morfologjike më të shprehura i përkasin kreshtës monoklinale të Mirakës me një gjatësi rreth 18 km, gjerësi 2 - 2.5 km dhe lartësi 1200 – 1900 m (maja e Rinasit 1998 m). Në shtrirje kjo kreshtë ndërpritet nga gryka e Zdrajshit e formuar nga dega e djathtë e përroit të Qarrishtës, e cila ka shfrytëzuar një shkëputje tektonike tërthore lokale, duke u shprehur tek ndryshimet e lartësive midis dy pjesëve të kësaj kreshte të ndara prej saj (Gj. Gruda, 1996).

## **KURRIZI KODRINORO – MALOR I KUTËRMANIT**

Në kuadrin e malësisë së Çermenikës ky kurriz kodrinoro – malor shtrihet në skajin JL të saj, i cili veçohet nga kufij morfotektonik e morfologjik të shprehur nëpërmjet kontrasteve morfologjike me relievin kufizues. Në përgjithësi ka një drejtim VP – JL me gjatësi rreth 12 km nga lugu i Shmilit deri te gryka e Mirakës, një gjerësi 7 – 10 km dhe lartësi 600 – 1100 m

(maja e Ulokut 1181 m), por pjesa më e madhe shtrihet deri në 600 – 900 m. Theksojmë se pavarësisht nga karakteri bllokor i strukturës së këtij kurrizi kodrinoro – malor, ai në tërësi ruan njëkohësisht trajtën monoklinale, lidhur, gjithashtu me një rrënjë të përgjithshme VL me kënd deri në  $50^0 - 70^0$  të masivit ultrabazik, duke u shprehur në reliev me tiparet morfologjike të një kreshte monoklinale (Gj. Gruda, 1994). Kulmi i kësaj kreshte shtrihet midis majës së Ulokut (1181 m) në JL dhe asaj të Venikës (1109 m) nga VP, duke u modeluar në pjesën dërrmuese në masivin ultrabazik të Kutërmanit, i cili përfshihet pothuajse tërësisht në shpatin VL, pra shpinën e kësaj kreshte.

## SEKTORI PERËNDIMOR I ÇERMENIKËS

Në kuadrin morfologjik të malësisë së Çermenikës sektori perëndimor veçohet menjëherë për tiparet karakteristike të relievit ndaj sektorit lindor të trajtuar më lart. Kufiri natyror morfotektonik e morfologjik midis tyre kalon gjatë antiklinalit gëlqeror të Gurit të Muzhaqit dhe kurrizit kodrinoro – malor me të njëjtin emër. Në drejtim të veriut fusha e Bizës e veçon nga blloku malor gëlqeror i Valit të Martaneshit, në jug lugu i Shmilit e ndan prej kurrizit kodrinoro – malor të Kutërmanit, kurse në perëndim kurrizi malor ujëndarës midis lumenjve Erzen dhe Shkumbin përfaqson kryesisht një kufi natyror orientues falë ngjashmërisë me relievin e rrjedhjes së sipërme të Erzenit. Shtrirja e përgjithshme e këtij sektori arrin afro  $80 \text{ km}^2$ , duke përfaqësuar territorin më të gërryer të kësaj malësie dhe më gjerë, në të cilën relievi paraqitet me kontraste morfologjike të theksuara falë përbërjes litologjike me ndryshime të theksuara ndaj dukurive gërryese veçanërisht të rrjedhjeve ujore sipërfaqësore. Kreshta monoklinale me lartësinë më të madhe, por me gjatësinë më të vogël (rreth 2 km) dhe asimetri strukturore relativisht më pak të shprehur e ka ajo midis majës së Kësulës (1622 m) dhe asaj të Mexhidit (1403 m) ndërmjet lugut të Shpellës dhe atij të Rinasit. Vazhdimin VP të kësaj kreshte e ndërpret një qafë tektonike deri tek maja e Sojës (1407 m), ku ajo përfundon tek fillimi i lumit Erzen (fshati Urë). Në kuadrin e një relievi tepër të copëtuar dhe me kontraste morfologjike të theksuara veçohet, gjithashtu, ai i modeluar në skajin perëndimor të këtij sektori, i cili dallohet për shtrirjen më të gjerë të shkëmbinjve gëlqerorë, pra ai midis qafës tektonike të Qenamit në JL dhe asaj të Kollogjeshit nga VP (Gj. Gruda, 1996). Ky brez i gjerë gëlqeror është me gjatësi rreth 3 km dhe gjerësi afro 2 km, i cili ndërpritet prej qafës tektonike të Kumbullës, ka trajtën e një blloku me lartësi 1100 – 1300 m dhe zhvillim të dendur të karstit sipërfaqësor i përfaqësuar kryesisht prej hinkave dhe dolinave, veçanërisht tek pjesa veriore. Ndër lugjet kryesore në këtë malësi janë

nënjësitë morfologjike si: lugu i Lunikut, Qarrishtës, Gurakuqit dhe Shmilit.

Në përbërësit morfologjik të malësisë së Çermenikës përfshihet, gjithashtu, lugu i Lunikut, i cili shtrihet midis kurrizit malor me të njëjtin emër në lindje dhe atij të Gurit të Muzhaqit në perëndim. Në veçoritë morfotektonike të këtij lugu, pavarësisht nga gjatësia relativisht e vogël (rreth 15 km), është formimi i tij në dy zona tektonike, në atë të Krasta – Cukalit deri në Prevallë (rreth 10 km) dhe të Mirditës tek fshati Funarë, të cilat përfaqësohen në pjesën dërrmuese prej shkëmbinjve terrigjen (Sh. Aliaj, 2012).

Lugu i Qarrishtës shtrihet midis bllokut malor të Shebenikut në jug me përbërje tërësisht ultrabazike, kreshtës gëlqerore të Mirakës nga veriu në rreth 15 km gjatësi, kurse në perëndim hapet menjëherë në skajin VP të pellgut sinklinal të Librazhdit. Prania e rrjetit ujqor të këtyre degëve ka ndikuar në vlera të mëdha të dendësisë ( $3 - 5 \text{ km/km}^2$ ) së copëtimit dhe në ato mesatare të thellësisë së këtij copëtimi ( $200 - 300 \text{ m/km}^2$ ), duke përcaktuar njëkohësisht një trajtë të përthyer në shtrirje të këtij shpati. Një dukuri tjetër morfologjike e këtij shpati është, gjithashtu, trajta e shkallëzuar e tij falë një shkëputje tektonike gjatësore midis Qarrishtës e Kosharishtës pranë mbylljes së masivit ultrabazik të Shebenikut, duke çuar në formimin e një shkalle strukturore në lartësi 1100 – 1400 m ku shtrihen fshatrat me të njëjtin emër.

Lugu i Gurakuqit veçohet menjëherë në kuadrin strukturor, sepse është modeluar pothuajse gjatë ballit të mbihijjes ndërmjet dy zonave tektonike, pra asaj të Mirditës në lindje dhe Krasta – Cukalit nga perëndimi, duke u modeluar gjatë një brezi të gjerë shkatërrimi tektonik. Trajta relativisht më e rregullt e këtij shpati paraqitet tek ndërprerja e kreshtës monoklinale midis majës së Sukës dhe asaj të Sqepurit, duke përfshirë dhe atë nga e djathta e lugut të Shpellës. Shtrati i këtij lugu është zallistor dhe zgjerohet doradorës nga 50 – 100 m deri në 150 – 200 m midis Gurakuqit dhe Orenjës, pra tek zgjerimi i dukshëm i brezit terrigjen deri në afro 2 km, duke përfshirë edhe anën e djathtë të lugut të Shpellës. Në përmasa të përafërta siç u theksua më lart, paraqitet edhe lugu tektonik i Shpellës, i cili hapet gjerësisht tek ai i Gurakuqit, menjëherë në fshatin me të njëjtin emër.

Në skajin jugor të këtij sektori shtrihet lugu i fundit dhe njëherë me gjatësi më të madhe (rreth 13 km), ai i Shmilit, një pjerrësi të shtratit rreth 23 m/km dhe trajtën tipike gjysmërrethi me lugëzim drejt JL midis fshatit Qerret në perëndim dhe Kutërmanit nga lindja. Lidhur me shtratin e këtij lugu ai zgjerohet doradorës menjëherë nga grykëderdhja e përroit të Benës, duke arritur vlera 150 – 250 m tek bashkimi me lugun dhe përroit e Gurakuqit. Ky lug dhe përgjatë tij ndryshojnë emrin nga Floqi tek grykëderdhja e përroit të Zdrajshit, duke u cilësuar si përroi i Gjurajt, me tipare

morfologjike karakteristike falë përbërjes litologjike të ndryshuar, duke u karakterizuar, gjithashtu, nga një asimetri strukturore e dukshme e shpateve.

## KONKLUZIONE

Shtrirja e kësaj malësie i kalon kufijtë e Çermenikës si emërtim etnografik, prandaj nuk ka përse të krijohen keqkuptime në lidhje me ruajtjen e këtij emërtimi .

Në sektorin perëndimor të Çermenikës, veçanërisht nga qafa e Rinasit në veri deri tek Labinoti Mal nga jugu, shtrihen strukturat antiklinale dytësore të gëlqerorëve kretak të zonës së Krastës, të cilën shprehen drejtpërdrejtë në reliev me kurrize malore mbi 1200 – 1400 m lartësi.

Zhvillimin më të dendur relievi karstik gjatë këtij kurrizi e ka midis majës së Lunikut dhe majës së Gurit (1825 m), i cili përfaqësohet nga hinka dhe pjesërisht dolina, megjithatë, densiteti më i madh i zhvillimit të karstit takohet tek blloku VP midis dy grykave të lartpërmendura, duke u lidhur drejtpërdrejtë me shtrirjen më të gjerë të shkëmbinjve gëlqerorë.

Një dukuri morfologjike karakteristike e Gurit të Muzhaqit është fakti se lartësia më e madhe e tij nuk përputhet me përmasat e shtrirjes së shkëmbinjve gëlqerorë, pra Guri i Muzhaqit shtrihet në skajin verior ku këta shkëmbinj kanë njëkohësisht shtrirje gati sa gjysma e pjesës jugore.

Tiparet morfologjike më të shprehura i përkasin kreshtës monoklinale të Mirakës me një gjatësi rreth 18 km, gjerësi 2 - 2.5 km dhe lartësi 1200 – 1900 m (maja e Rinasit 1998 m).

Në sektorin perëndimor të Çermenikës kreshta monoklinale me lartësinë më të madhe, por me gjatësinë më të vogël (rreth 2 km) dhe asimetri strukturore relativisht më pak të shprehur e ka ajo midis majës së Kësulës (1622 m) dhe asaj të Mexhidit (1403 m) ndërmjet lugut të Shpellës dhe atij të Rinasit.

Ndër lugjet kryesore në këtë malësi janë nënnyjësitë morfologjike si: lugu i Lunikut, Qarrishtës, Gurakuqit dhe Shmilit.

## REFERENCAT

1. Aliaj, Sh., Neotektonika e Shqipërisë, Monografi, Tiranë, 2012.
2. Derbyshire, E., Geomorphology and climate, Wiley & S, London, 1976.
3. Gruda, Gj., Veçori morfologjike të rrëpirave dhe linjave të shkëputjeve tektonike në Shqipëri, Studime gjeografike, Nr. 8, Tiranë, 1996.



4. Gruda, Gj. Sala, S, & Ziu, T., Akullzimi i kuarternarit në Shqipëri dhe roli i tij në formimin e relievit, Studime gjeografike, Nr. 2, Tiranë, 1987.
5. Gruda, Gj., Gjeomorfologjia, Monografi, Tiranë, 2003.
6. Gruda, Gj., Relievet strukturore – erozive, Studime gjeografike, Nr. 5, Tiranë, 1994.
7. Grup autorësh., Harta gjeologjike e Shqipërisë dhe teksti sqarues Gjeologjia e Shqipërisë, Tiranë, 1983.
8. Grup autorësh., Gjeografia fizike e Shqipërisë. Vëllimi II, botim i Akademisë së Shkencave të RPSH, Tiranë, 1991.
9. Krutaj, F. & Qiriazhi, P., Proçeset e jashtme aktuale që modelojnë relievin e vendit tonë, Studime gjeografike, Nr. 2, Tiranë, 1987.
10. Meçaj, N., Kuçana, M., Disa veçori gjeomorfologjike të luginave lumore, Studime gjeografike, Nr. 17, Tiranë, 2006.
11. Qiriazhi, P., Gjeografia e Shqipërisë, Monografi, Tiranë, 2006.
12. Qirjazhi, P., Kristo, V., Gruda, Gj., Tiparet themelore gjeomorfologjike të Shqipërisë dhe disa probleme të praktikës, Studime gjeografike, Nr. 2, Tiranë, 1987.
13. Shallo, M., Gjata, Th., Vranai, A., Përfytyrime të reja mbi gjeologjinë e Albanideve lindore nën shembullin e rajonit Martanesh – Çermenikë – Klenjë, Përmbledhje studimesh, Nr. 2, Tiranë, 1980.